



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 838/4 prot.

Tiranë më 17.07.2019

**VENDIM**

Nr. 19, datë 17.07.2019

**PËR KONTROLLUESIN "MSA KONSTRUKSION SH.P.K."**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "MSA Konstruksion sh.p.k.",

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr.179 datë 31.05.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "MSA Konstruksion sh.p.k.", me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur nga një shtetas, lidhur me vendosjen e kamerave në ambientet e zhveshjes dhe saunës, zbatimi i ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "MSA Konstruksion sh.p.k.", konstaton se:

1. Kontrolluesi "MSA Konstruksion shpk", referuar ekstraktit historik të regjistrimit në QKB, ndër të tjera ka për objekt veprimtarie palestër-fitness-SPA, me vend të ushtrimit të aktivitetit "Njësia Fitnes" (Fit-Express), qendra tregtare "Ring Center", kati i katërt. Nëpërmjet këtij aktiviteti, kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë "abonentë/klientë dhe "punëmarrës". Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen për abonentët janë: "emër, mbiemër, vendlindje, datëlindje, adresa, nr. telefoni celular, email, fotografi, imazhe-video, etj".
2. Kontrolluesi disponon një manual për qëllim të informimit të punonjësit në lidhje me politikat dhe procedurat e kompanisë si dhe një rregullore për "Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale". Konstatohet se rregullorja është e përgjithshme dhe jo plotësisht në funksion të aktivitetit specifik "Njësia Fitnes" (Fit-Express) të kontrolluesit, nëpërmjet të cilave mbledh dhe përpunon të

dhëna personale. Konstatohet se përmbajtja e saj është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon kontrolluesi, etj.

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi i rregullores së mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale në funksion të aktivitetit specifik të tij, si dhe përdorimi nga nëpunësit si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe sqaron ata në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, rëndësinë, ruajtjen e fshehtësisë, ruajtjen nga keqpërdorimi, mënyrën e administrimit të tyre, etj.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", pika 2/1: "*Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat teknike-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera.*" dhe Vendimit nr. 6/2012 i Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*".

3. Konstatohet se palestra "*Njësia Fitnes*" (Fit-Express), është e mbikëqyrur nga një sistem video-survejimi (CCTV). Ambientet e survejuara janë dhomat e zhveshjes së klientëve (pjesë përbërëse është hyrja në sauna dhe shërbimi solar), recepsioni, etj. Ambientet e dhomave të zhveshjes janë të pajisura me dollapë me çelës, me qëllim vendosjen e sendeve personale të abonentëve.

Një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është sistemi i video-survejimit (CCTV). Kontrolluesi, nëpërmjet këtij mjeti përpunon të dhëna "*imazhe-video*" të subjekteve të të dhënave "*klientë*" dhe "*punëmarrës*". Sistemi i video survejimit nuk duhet të ndërhyjë në jetën private të individëve. Të dhënat e ruajtura në sistemin e video survejimit si "*imazhe*" apo "*video*", janë të dhëna personale për arsye se një individ mund të identifikohet drejtpërdrejtë apo tërthorazi në bazë të këtyre regjistrimeve. Një individ është i identifikueshëm, nëse imazhi në të cilën ai është regjistruar zbulon shenjat e tij dalluese dhe mundëson identifikimin e plotë të tij kur këto karakteristika krahasohen me të dhëna të tjera në dispozicion.

Përpunimi i të dhënave me anë të një sistemi video survejimi mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem, nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër. Instalimi i një sistemi video survejimi është i ndaluar në dhoma që përdoren ekskluzivisht për qëllime private si tualete, dushe, dhoma zhveshje. Përpunimi i të dhënave personale duhet të bazohet gjithashtu në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim. Përpunimi i të dhënave personale me anë të sistemit të video-survejimit (CCTV) pa pëlqimin e subjektit të të dhënave është i ligjshëm, por gjithnjë duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Konstatimi në lidhje me mbikëqyrjen nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV) të dhomave të zhveshjes, përbën shkelje administrative të neneve 5 dhe 6 të ligjit si dhe Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit "*Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*".

4. Në hyrje të ambienteve në të cilat ushtron aktivitetin, kontrolluesi nuk ka vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejimit. Tabelat informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejimit janë vendosur në brendësi/hyrje të dhomave të zhveshjes, megjithatë ato nuk informojnë subjektet e të dhënave "nëpunës", "klientë", "vizitorë" etj., mbi përpunimin e të dhënave personale imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë, etj., pasi nuk janë në përputhje me modelin standard të miratuar me Udhëzimin nr. 3/2010 të Komisionerit.

Mungesa e informimit të subjekteve të të dhënave lidhur me mbikëqyrjen e ambienteve nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV), përbën shkelje administrative të nenit 18, pika 1 të ligjit: "Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale" dhe Udhëzimit Nr.3/2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".

5. Konstatohet se kontrolluesi disponon një bazë të dhënash në formatin ".xls", në të cilën janë regjistruar të dhënat e 2872 abonentëve me status "aktiv" dhe "joaktiv". Të dhënat e regjistruara në këtë bazë të dhënash janë: emër, mbiemër, datëlindje, numër telefoni, periudha e abonimit etj. Të dhënat e klientëve dhe ish-klientëve, mbahen për qëllim pasqyrimi të ecurisë së aktivitetit si dhe identifikimin në mënyrë të shpejtë të ish-klientëve.

Referuar konstatimit në vend si dhe nenit 5 të ligjit, konkludohet se kontrolluesi mban në arshivën elektronike të dhënat e subjekteve "ish-klientë", në tejkalim të qëllimit specifik sipas kontratës për ofrimin e shërbimit, për të cilën të dhënat ishin mbledhur.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 5, pika "b": "në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime", dhe nenit 6 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar;

6. Konstatohet se në pikën 9 të kontratës me klientin për përdorimin e palestrës Fit-Express, parashikohet "Lirimi nga përgjegjësia dhe përdorimi i imazhit". Nën këtë pikë, abonenti deklaron se përjashton nga çdo përgjegjësi "MSA Konstruksion sh.p.k." (Fit-Express), ndër të tjera humbjen dhe vjedhjen e sendeve personale. Gjithashtu, abonenti informohet se gjatë aktivitetit të tij në palestër, do të zhvillohen regjistrime audio dhe video në të cilat ai mund të jetë pjesë e planeve të xhirimeve. Abonenti pranon dhe autorizon një gjë të tillë dhe se dhënia e të drejtave është pa pagesë dhe nuk ka kufizime të territorit dhe kohëzgjatjes. Abonenti/klienti autorizon botimin, shpërndarjen dhe komercializimin e pamjeve video në çdo kanal televiziv, internet dhe çdo media digjitale.

"Pëlqimi", është një nga 6 principet ligjore për përpunimin e të dhënave personale, parashikuar në pikën 1 të nenit 6 të ligjit. Në rastin ku kontrolluesi fillon një përpunim të dhënash, ai duhet të konsiderojë se cila është baza e përshtatshme ligjore për vazhdimin e përpunimit. Në përgjithësi, "pëlqimi" mund të jetë një bazë ligjore e përshtatshme, nëse subjektit të të dhënave i është ofruar kontroll, si dhe i është ofruar

mundësi e qartë për të pranuar apo refuzuar termat e ofruara, ose ti refuzojë i pakushtëzuar. Kur kërkon "pëlqimin", kontrolluesi duhet të vlerësojë nëse ai plotëson të gjitha kërkesat për të garantuar një "pëlqim" të vlefshëm. Nëse është marrë në përputhje me ligjin, "pëlqim" është një mjet që i mundëson subjektit të të dhënave kontroll nëse të dhënat personale të tija do të përpunohen apo jo. Në rast se jo, kontrolli i subjekteve mbi përpunimin e të dhënave, do të ishte imagjinar dhe "pëlqimi" do të ishte një bazë ligjore jo e saktë për përpunimin, duke e bërë procesin e përpunimit të paligjshëm.

Sa i përket parashikimit në kontratë, në të cilën cilësohet se abonenti mund të jetë pjesë regjistrimeve video/audio, pranon dhe autorizon një gjë të tillë dhe se dhënia e të drejtave është pa pagesë dhe nuk ka kufizime të territorit dhe kohëzgjatjes, përbën një vendim marrje automatike ("Vendimmarrje automatike" është një lloj vlerësimi për individët, i kryer krejtësisht në mënyrë automatike, pa ndërhyrjen e individit. ). Referuar pikës 1, të nenit 14 të ligjit: "*Çdo person ka të drejtë të mos jetë subjekt i vendimeve, të cilat shkaktajnë efekte ligjore për të ose ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek ai dhe kur vendimi është bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, që synojnë të vlerësojnë disa aspekte personale, që lidhen me të, veçanërisht, efektivitetin në punë, besueshmërinë ose sjelljen.*"

Nëpërmjet nënshkrimit të kontratës, abonenti (subjekt i të dhënave), nuk informohet në lidhje me të drejtën e tij për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave sipas parashikimeve në shkronjat "d" dhe "dh" të nenit 6 të ligjit. E drejta e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar një përpunim të dhënash është e parashikuar në nenin 15 të ligjit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të neneve 6 (pika 1, gërma "a": "*nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin*"), 14 (pika 1: "*Çdo person ka të drejtë të mos jetë subjekt i vendimeve, të cilat shkaktajnë efekte ligjore për të ose ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek ai dhe kur vendimi është bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, që synojnë të vlerësojnë disa aspekte personale, që lidhen me të, veçanërisht, efektivitetin në punë, besueshmërinë ose sjelljen*") dhe 15 (pika 1: Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kundërshtojë, në çdo kohë, mbështetur në ligj, përpunimin e të dhënave rreth tij, sipas shkronjave "d" dhe "dh" të nenit 6 të këtij ligji, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj) të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

7. Në rubrikën "*Miratim për përpunimin e të dhënave personale*" konstatohet se abonenti jep pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale dhe të ndjeshme duke përfshirë të dhënat biometrike, nga "*MSA Konstruktion shpk*", në zbatim të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Pjesë e procedurës së regjistrimit të abonentit, u konstatua të jetë regjistrimi në një sistem elektronik, nëpërmjet të cilit merret edhe një fotografi (specifikisht) e fytyrës së tij. Të dhënat biometrike të tilla si shenjat e gishtave, irisi, retina, tiparet e fytyrës etj., ofrojnë burime të karakteristikave që janë unike dhe i atribuohen vetëm një individit dhe duke qenë karakteristika unike, ato padyshim përbëjnë të dhëna personale. Çdo mbledhje, ruajtje, ndarje apo shkatërrim i këtyre të dhënave

konsiderohet si përpunim i të dhënave personale, dhe për pasojë duhet të rregullohet posaçërisht nga dispozitat e ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Konstatimi, sa i përket përpunimi të të dhënave të ndjeshme dhe biometrike, përbën shkelje administrative të nenit 6 dhe 7 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

8. Në fund të kontratës, është miratimi dhe nënshkrimi për dhënien e dakordësisë për marrjen e informacioneve komerciale dhe promovuese nëpërmjet mesazheve telefonike apo email-it, nga shoqëria. Nuk konstatohet që abonenti të ketë mundësi të qartë për të zgjedhur nëpërmjet alternativës nëse dëshiron apo jo të marrë mesazhe promocionale nga kontrolluesi.

Konstatimi sa i përket mënyrës së informimit dhe marrjes së pëlqimit (sipas arsytimit në pikën 6 të relacionit) të subjektit të të dhënave, përbën shkelje administrative të neneve 6, 14 dhe 15 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua edhe nga përfaqësuesja e kontrolluesit, e cila parashtrroi komentimin se: "Pretendimet do të paraqiten me shkrim brenda 3 ditëve". Një kopje e procesverbalit iu vu në dispozicion përfaqësueses së kontrolluesit.

Kontrolluesi ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit më datë 24.06.2019, pretendimet me shkrim në lidhje me konstatimet e grupit të kontrollit, si më poshtë vijon:

- Sa i përket rregullores për përpunimin e të dhënave personale, ju bëjmë me dije se aktiviteti Fit-Express është i ri për shoqërinë tonë dhe për këtë arsye jemi në proces përshtatje të rregullores;
- Sa i përket vendosjes së kamerave në ambientet në të cilat ushtrohet aktiviteti, përpunimi i të dhënave është bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën "dh" të nenit 6 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Vendosja e sistemit të video-survejtimit në dhomat e zhveshjes është bërë për të mbrojtur të drejtat e pasurore të klientëve e në mënyrë të veçantë të sendet personale, për arsye se kemi pasur ankesa për vjedhje
- Sa i përket konstatimit në lidhje me tabelat informuese, janë marrë masa për zëvendësimin e tyre me tabelat sipas modelit të miratuar në udhëzimin përkatës të Komisionerit.
- Sa i përket konstatimit në lidhje me mbajtjen e të dhënave të klientëve joaktiv, bëjmë me dije se të dhënat janë trajtuar në respekt të përcaktimeve të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, megjithatë mirëpresim rekomandimin e Komisionerit për të vepruar më tej.
- Sa i përket konstatimit në lidhje me "Lirimi nga përgjegjësia dhe përdorimi i imazhit" si dhe përjashtimin e MSA Konstruktion nga përgjegjësia në rast vjedhjesh apo

humbjen e sendeve personale, bëjmë me dije se MSA Konstruksion nuk mund të mbajë përgjegjësi për dëmet/vjedhjet që klientët mund ti bëjnë njërit tjetrit dhe për këtë arsye është vendosur sistemi i kamerave në dhomat e zhveshjes.

- Sa i përket konstatimit në lidhje me përpunimin e të dhënave biometrike, MSA Konstruksion merr realisht vetëm të dhënat e përshkruara në faqen e parë të formularit dhe nga autorizimi që merr nga abonenti i lind e drejta dhe ka detyrimin që të bëjë përpunimin e tyre sipas parashikimeve të ligjit. Të dhënat biometrike kanë të bëjnë vetëm me fotografinë që i merret abonentit nëpërmjet sistemit elektronik të regjistrimit të tyre për akses në ambientet e palestrës, për qëllim identifikimi. Në çdo rast merret nënshkrimi/autorizimi i abonentit për përdorimin e të dhënave personale nga MSA Konstruksion për qëllim të kontratës.
- Sa i përket konstatimit të pikës së tetë të procesverbalit, bëjmë me dije se një kopje e kontratës i jepet paraprakisht abonentit dhe më mbas ai vijon me plotësimin dhe nënshkrimin e tij. Pra nuk kemi të bëjmë me një formular që imponohet për tu plotësuar.

Bashkëlidhur: një kopje formulari të regjistrimit të abonentit, rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejimit në hyrje të palestrës, modele kontratash me abonentët.

Në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", kontrolluesi "*MSA Konstruksion sh.p.k.*" është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi është paraqitur në seancë dhe ka arsyetuar qëndrimin, sipas pretendimeve të paraqitura me shkrim.

Ndaj Kontrolluesit "*MSA Konstruksion sh.p.k.*" është kryer më parë hetim administrativ, ku nëpërmjet Vendimit nr. 39 datë 01.10.2015 të Komisionerit, është vendosur: Dënimi i kontrolluesit "*MSA Konstruksion shpk*", me gjobë në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Si përfundim, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të hetimit administrativ e cila konsiston në mbikëqyrjen e zonave të cilat përdoren ekskluzivisht për qëllime private si hyrja në sauna, solari, dhoma e zhveshjes, përbën shkelje të rëndë dhe në kuptim të nenit 39, pika 1, gërmat "a", të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë:

- a) "*Kontrolluesit që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me Kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 15.000 deri në 500.000 lekë*";

Kontrolluesi "*MSA Konstruksion sh.p.k.*", në formën ligjore të aktivitetit të vet tregtar, është person juridik dhe sipas nenit 39/2 të Ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, për kundërvajtjet e mësipërme dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë procesit të hetimit administrativ dhe reagimin e menjëhershëm për rikuperimin e pjesshëm të disa prej shkeljeve të konstatuara.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 5, 6, 7, 14, 15, 18, 20, 27, 29, 30, 31 (pika 1 gërma a/1) 39 (pika 1 gërmat "a"), si dhe nenet 40 dhe 41 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar,

### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit "*MSA Konstruksion sh.p.k.*", me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.
2. Kontrolluesi "*MSA Konstruksion sh.p.k.*", të ndalojë përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV) në zonat të cilat përdoren ekskluzivisht për qëllime private si hyrja në sauna, solari, dhoma e zhveshjes, duke hequr përfundimisht kamerat përkatëse që mbulojnë këto ambiente.
3. Kontrolluesi "*MSA Konstruksion sh.p.k.*", të shkatërrojë të gjitha të dhënat personale imazhe-video të siguruara nga sistemi i video-survejimit (CCTV) nëpërmjet kamerave të vendosura në zonat të cilat përdoren ekskluzivisht për qëllime private si hyrja në sauna, solari, dhoma e zhveshjes, në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.
4. Kontrolluesi "*MSA Konstruksion sh.p.k.*", të shkatërrojë të gjitha të dhënat personale të grumbulluara në kontratat me "*klientët/abonentët*", në regjistrin elektronik të klientëve në formatin ".xls" dhe në sistemin elektronik të administrimit të "*klientëve/abonentëve*", të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.
5. Kontrolluesi "*MSA Konstruksion sh.p.k.*", të marrë masa konkrete në lidhje me përpunimin e të dhënave të subjekteve "*klientët/abonentët*", në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe në veçanti, në rregullimin e mekanizmit të "*pëlqimit*" si një mjet që i mundëson subjektit të të dhënave kontroll nëse të dhënat e tija personale do të përpunohen apo jo nga kontrolluesi.
6. Kontrolluesi "*MSA Konstruksion sh.p.k.*", të ketë në vëmendje përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, si dhe të drejtat ligjore që gëzojnë subjektet e të dhënave, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

7. Kontrolluesi "MSA Konstruksion sh.p.k.", të ketë në vëmendje hartimin e rregullores dhe dokumentimin e të gjitha proceseve dhe procedurave në lidhje me përpunimin e të dhënave për të cilat është përgjegjës, duke parashikuar masa konkrete organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat dhe aksesin në të dhëna, të drejtat e subjekteve të të dhënave etj., në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe Vendimit nr.6/2012 të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale".
8. Kontrolluesi "MSA Konstruksion sh.p.k.", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 5 ditor për pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6 dhe 30 ditor për pikën 7 të këtij Vendimi, nga momenti i marrjes dijeni, dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
9. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.
10. Gjyba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
11. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 17.07.2019.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

